

VENDIM
Nr.826, datë 13.10.2010

PËR KUOTAT E PRANIMEVE NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR STUDIMET E CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME, E TË EDUKIMIT NË DISTANCË, NË VITIN AKADEMIK 2010 – 2011

(Ndryshuar me VKM nr. 936, datë 17.11.2010; nr. 1071, datë 29.12.2010)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 33, 35, 36 dhe 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të ligjit nr.8626, datë 22.6.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbrit”, dhe të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e përgjithshme të pranimeve të reja në institucionet publike të arsimit të lartë, për studimet e ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, për vitin 2010-2011, të jenë 9940. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

<i>a) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme</i>	<i>9400;</i>
<i>b) Kuotat e pranimeve të reja, në programet e studimit të ciklit të parë, të edukimit në distancë</i>	<i>40;</i>
<i>c) Kuotat për transferim studimesh</i>	<i>200;</i>
<i>ç) Kuota për shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetas të tjerë të huaj</i>	<i>100;</i>
<i>d) Kuota për të verbrit</i>	<i>20;</i>

dh) Kuota për romët/ ballkano-egjiptianët

20;

e) Kuota për të përndjekurit politikë

160.

2. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, e të edukimit në distancë, sipas shkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij vendimi, të shpërndahen sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Kuota e çdo programi studimi ndahet në raportin 4:1, përkatësisht, 80 % e kuotës jepet për pranimet e reja për programe studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, dhe 20 % për pranimet e reja për programe të dyta studimi.

3. Kuota për transferim studimesh, e përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve publike të arsimit të lartë.

4. Kuota për shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, ndahet ndërmjet aplikantëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja. Këto kuota administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe të marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

5. Kuota për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, të përcaktuara në shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij vendimi, administrohet nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe shpërndahet në bazë të legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe.

6. Kuota e pranimeve për të verbrit ndahet për aplikantët me statusin e të verbrit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve.

7. Kuota e pranimeve për romët dhe ballkano-egjiptianët ndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga shoqatat respektive, përkatësisht, Shoqata Kombëtare e Romëve dhe Shoqata Kombëtare e Ballkano-Egjiptianëve.

8. Kuota e pranimeve për të përndjekurit politikë ndahet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Instituti i Integritetit të të Përndjekurve Politikë. Pranimet do të bëhen vetëm në rast të plotësimit të kriterëve të vendosura nga institucionet publike të arsimit të lartë.

9. Çdo shtetas shqiptar, i cili ka përfunduar shkollën e mesme dhe zotëron dëftesë pjekurie apo çdo diplomë tjetër studimi, të fituar brenda ose jashtë vendit, të barasvlershme me të, ka të drejtë të aplikojë për në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë.

10. Transferimet e studentëve në numrin përkatës të kuotës, të përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me kriteret e përcaktuara e të bëra publike paraprakisht.

11. Aplikantët që dëshirojnë të ndjekin studimet me kohë të pjesshme, në një program të dytë studimi, brenda kuotës së përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, e fitojnë këtë të drejtë sipas kriterëve të përcaktuara nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë e të bëra publike paraprakisht.

12. Tarifat e shkollimit (për 180 kredite) dhe tarifat e shkollimit për çdo kredit për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë,

në programet e studimit të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2010 - 2011, të jenë, për çdo program studimi dhe institucion publik të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në tabelën nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

13. Tarifat e shkollimit (për 180 kredite) dhe tarifat e shkollimit për çdo kredit për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, në programe të dyta studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, në vitin akademik 2010 - 2011, të jenë, për çdo program studimi dhe institucion publik të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve të bëra në tabelën nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

14. Përfshihen nga tarifa e shkollimit aplikantët që fitojnë të drejtën për të studiuar në një program studimi të ciklit të parë, me kohë të pjesshme, si program i parë studimi, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2010 - 2011, të cilët u përkasin këtyre kategorive sociale: të verbrit, të shurdhërit, invalidët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë, fëmijë që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijë të familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, fëmijë të ish-të përndjekurve politikë, fëmijë romë dhe ballkano - egjiptianë.

15. Këtë të drejtë e kanë edhe studentët e viteve më të larta, që u përkasin po këtyre shtresave shoqërore.

16. Studentët e paguajnë tarifën e shkollimit, të ndarë në këste vjetore, në përputhje me kreditet e lëndëve që do të frekuentojnë në çdo vit akademik. Studenti i nënshtrohet tarifës së shkollimit për një lëndë sa herë e frekuenton atë.

17. Studentët e shkëlqyer nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin pasardhës.

18. Shqiptarët nga trojet jashtë kufijve të vendit dhe shtetasit e tjerë të huaj, që do të vazhdojnë studimet në një program studimi, me kohë të pjesshme, në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje zyrtare, shtetërore, janë përcaktuar mënyra të tjera për tarifën.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela nr.1/1

KUOTA E PRANIMEVE TË REJA NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, ME KOHË TË PJESSHME DHE
EDUKIM NË DISTANCË NË VITIN AKADEMIK 2010-2011
(Ndryshuar me VKM nr. 936, datë 17.11.2010)

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	UT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UD	UST	Shuma
1.	Histori	250					120			370

2.	Gjeografi	250				120		370
3.	Histori-Gjeografi		100	100				200
4.	Gjuhë-Letërsi	250	100	100	110	120		680
6.	Edukatë Qytetare		80					80
7.	Cikli i ulët		120	50	50	110	160	490
8.	Cikli i ulët (Filiali Peshkopi)					200	60	260
9.	Cikli i ulët parashkollor		130	100	75	120		425
10.	Edukim Fizik dhe Sporte						60	60
11.	Matematikë					60		60
12.	Teknologji Informacioni		50					50
13.	Fizikë					60		60
14.	Matematikë-Fizikë		70	100				170
15.	Biologji-Kimi		70	100		70		240
16.	Biologji	200						200
17.	Punë Sociale	100	100					200
18.	Filozofi-Sociologji		80					80
19.	Psikologji Sociologji						160	160
20.	Ekonomia dhe e Drejta		80					80
21.	Psikologji	100						100
22.	Drejtësi	400				130	100	630
23.	Drejtësi (filiali Peshkopi)						60	60
24.	Infermieri e Përgjithshme	260	105		280		100	790
25.	Infermieri e Përgjithshme (fil. Peshkopi)						60	60
26.	Mami	60						60
27.	Teknik Imazherie	90						90
28.	Teknik Laboratori	100						100
29.	Fizioterapi	80						80
30.	Administrim Publik			100				100
31.	Administrim-Biznes	200	105			100	200	605
32.	Financë-Kontabilitet	200	105	100	100	100	200	805

33.	Financë-Kontabilitet (filiali Peshkopi)							60		60
34.	Menaxhim				90					90
35.	Turizëm			100	75		100			275
36.	Marketing				75					75
37.	Turizëm (Pogradec)				60					60
39.	Menaxhim Agrobiznesi	100			75					175
40.	Ekonomi dhe P. Agrare	100								100
41.	Financë-Kontabilitet	100								100
42.	Mbrojtje bimësh	50								50
43.	Hortikulturë	50			75					125
44.	Prodhim bimor	50								50
45.	Zootekni dhe Biznes Blegtoral	50								50
46.	Akuakulturë dhe Menaxh. Peshkimi	50								50
47.	Agromjedis dhe Ekologji	80								80
48.	Tek. Agroushqimore	50			75					125
49.	Vreshtari-Enologji	50								50
50.	Inxhinier Pyjesh	60								60
51.	Inxhinier Përpunim Druri	60								60
52.	Agromekanizim	50								50
	GJITHSEJ	2540	900	1340	850	1140	1410	1160	60	9400

PROGRAMI I STUDIMIT	UPT
Inxh.Mek/Inxh.Logjistik Prodhimi	40

TABELA NR. 2/1
TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR PROGRAM TË PARË STUDIMI ME KOHË TË
PJESSHME PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011
(Ndryshuar me VKM nr. 936, datë 17.11.2010; nr. 1071, datë 29.12.2010)

Nr.	Universiteti	Tarifë për kredit për program të parë	Tarifë totale për program të parë
	Universiteti Bujqësor i Tiranës Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit		
1	Hortikulturë	700	126,000
2	Mbrojtje Bimësh	700	126,000
3	Prodhim Bimor	700	126,000
4	Zootekni dhe Biznes Blegtoral	700	126,000
5	Akuakulturë dhe Menaxhim Peshkimi	700	126,000
6	Agromjedis dhe Ekologji	700	126,000
7	Agromekanizim	700	126,000
	Fakulteti i Ekonomisë dhe i Agrobiznesit		
8	Menaxhim Agrobiznesi	750	135,000
9	Ekonomi dhe Politikë Agrare	750	135,000
10	Finance -Kontabilitet	750	135,000
	Fakulteti i Shkencave Pyjore		
11	Mbarështim Pyjesh	700	126,000
12	Përpunim Druri	700	126,000
	Fakulteti i Bioteknologjisë dhe i Ushqimit		
13	Teknologji Agroushqimore	700	126,000
14	Vreshtari Enologji	700	126,000
	Universiteti i Tiranës Fakulteti i Ekonomisë		
1	Financë	750	135,000
2	Administrim-Biznes	750	135,000
	Fakulteti i Shkencave Natyrore		
3	Biologji	1 100	198,000
	Fakulteti Histori -Filologji		
4	Histori	850	153,000
5	Gjeografi	850	153,000
6	Gjuhë-Letërsi	850	153,000
	Fakulteti i Drejtësisë		
7	Drejtësi	550	99,000
	Fakulteti i Shkencave Sociale		
8	Psikologji	850	153,000

9	Punë Sociale	850	153,000
	Fakulteti i Infermierisë		
10	Infermieri	1,100	198,000
11	Mami	1,100	198,000
12	Teknik Imazherie	1,100	198,000
13	Teknik Laboratori	1,100	198,000
14	Fizioterapi	1,100	198,000
	Universiteti i Sporteve Tiranë		
1	Shkenca të Lëvizjes	1,800	324,000
	Universiteti Politeknik		
1	Inxhinieri Mekanike (Edukim në distancë)	1,800	324,000
	Universiteti i Gjirokastrës Fakulteti i Shkencave Shoqërore		
1	Cikli i Ulët	850	153,000
2	Cikli i Ulët Parashkollor	850	153,000
3	Kontabilitet-Financë	750	135,000
4	Administrim Publik	750	135,000
5	Turizëm	750	135,000
6	Histori-Gjeografi	850	153,000
7	Gjuhë -Letërsi	850	153,000
	Fakulteti i Shkencave të Natyrës		
8	Bio-Kimi	1,100	198,000
9	Matematikë-Fizikë	600	108,000
	Universiteti i Korçës Fakulteti i Ekonomisë		
10	Financë	750	135,000
11	Menaxhim	750	135,000
12	Marketing	750	135,000
13	Turizëm	750	135,000
14	Turizëm/Pogradec	750	135,000
	Fakulteti i Mësuesisë		
15	Cikli i Ulët	850	153,000
16	Cikli i Ulët Parashkollor	850	153,000
17	Gjuhë-Letërsi	850	153,000
18	Infermieri	1,100	198,000
	Fakulteti i Bujqësisë		
19	Agrobiznes	1,100	198,000
20	Hortikulturë	1,100	198,000
	Universiteti i Elbasanit		
1	Punonjësi Social	850	153,000
2	Filozofi-Sociologji	850	153,000
3	Gjuhë-Letërsi	850	153,000
4	Histori-Gjeografi	850	153,000
5	Edukatë Qytetare	850	153,000

6	Financë-Kontabilitet	750	135,000
7	Administrim-Biznes	750	135,000
8	Cikli i Ulët	850	153,000
9	Cikli i Ulët Parashkollor	850	153,000
10	Matematikë-Fizikë	600	108,000
11	Biologji-Kimi	1,100	198,000
12	Edukim Fizik e Sporte	1,700	288,000
13	Infermieri	1,100	198,000
14	Ekonomia dhe e Drejta	750	135,000
15	Teknologji Informacioni	850	153,000
	Universiteti i Shkodrës Fakulteti i Ekonomisë		
1	Administrim-Biznesi	750	135,000
2	Financë-Kontabilitet	750	135,000
3	Turizëm	750	135,000
	Fakulteti i Drejtësisë		
4	Drejtësi	550	99,000
	Fakulteti i Shkencave të Edukimit		
5	Cikli i ulët	850	153,000
6	Cikli i Ulët Parashkollor	850	153,000
7	Edukim Fizik e Sporte	1,800	324,000
	Fakulteti i Shkencave të Natyrës		
8	Matematikë	600	108,000
9	Fizikë	600	108,000
10	Biologji-Kimi	1,100	198,000
11	Infermieri	1,100	198,000
	Fakulteti i Shkencave Shoqërore		
11	Gjuhë-Letërsi	850	153,000
12	Histori	850	153,000
13	Gjeografi	850	153,000
	Universiteti i Durrësit Fakulteti i Biznesit		
1	Administrim-Biznes	750	135,000
2	Financë-Kontabilitet	750	135,000
3	Financë-kontabilitet (Fil. Peshk)	750	135,000
	Fakulteti i Shkencave Politik- Juridike		
4	Drejtësi	550	99,000
5	Drejtësi (Fil. Peshk)	550	99,000
	Fakulteti i Edukimit		
6	Cikli i Ulët	850	153,000
7	Cikli i ulët (Fil. Peshk)	850	153,000
8	Psikologji-Sociologji	850	153,000
	Fakulteti i Studimeve Profesionale		
9	Infermieri	1,100	198,000

10	Infermieri (Fil. Peshk)	1,100	198,000
----	-------------------------	-------	---------

TABELA NR.3/1
TARIFAT E SHKOLLIMIT PËR PROGRAM TË DYTË STUDIMI ME KOHË TË
PJESSHME PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011
(Ndryshuar me VKM nr. 936, datë 17.11.2010; nr. 1071, datë 29.12.2010)

Nr.	Universiteti	Tarifë për kredit për program të dytë	Tarifë totale për program të dytë
	Universiteti Bujqësor i Tiranës Fakulteti i Bujqësisë dhe i Mjedisit		
1	Hortikulturë	1,300	234,000
2	Mbrojtje Bimësh	1,300	234,000
3	Prodhim Bimor	1,300	234,000
4	Zootekni dhe Biznes Blegtoral	1,300	234,000
5	Akuakulturë dhe Menaxhim Peshkimi	1,300	234,000
6	Agromjedis dhe Ekologji	1,300	234,000
7	Agromekanizëm	1,300	234,000
	Fakulteti i Ekonomisë dhe i Agrobiznesit		
8	Menaxhim Agrobisnesi	850	153,000
9	Ekonomi dhe Politikë Agrare	850	153,000
10	Financë-Kontabilitet	850	153,000
	Fakulteti i Shkencave Pyjore		
11	Mbarështim Pyjesh	1,300	234,000
12	Përpunim Druri	1,300	234,000
	Fakulteti i Bioteknologjisë dhe i Ushqimit		
13	Teknologji Agroushqimore	1,300	234,000
14	Vreshtari Enologji	1,300	234,000
	Universiteti i Tiranës Fakulteti i Ekonomisë		
1	Financë	1,500	270,000
2	Administrim-Biznesi	1,500	270,000
	Fakulteti i Shkencave Natyrore		
3	Biologji	1,500	270,000
	Fakulteti Histori-Filologji		
4	Histori	1,500	270,000
5	Gjeografi	1,500	270,000
6	Gjuhë-Letërsi	1,500	270,000
	Fakulteti i Drejtësisë		
7	Drejtësi	1,500	270,000
	Fakulteti i Shkencave Sociale		

8	Psikologji	1,500	270,000
9	Punë Sociale	1,500	270,000
	Fakulteti i Infermierisë		
10	Infermieri	1,500	270,000
11	Mami	1,500	270,000
2	Teknik Imazherie	1,500	270,000
13	Teknik Laboratori	1,500	270,000
14	Fizioterapi	1,500	270,000
	Universiteti i Sporteve të Tiranës		
1	Shkenca të Lëvizjes	2,000	360,000
	Universiteti Politeknik		
1	Inxh. Mek.(Eduk. distancë)	2,000	360,000
	Universiteti i Gjirokastrës Fakulteti i Shkencave Shoqërore		
1	Cikli i Ulët	1,100	198,000
2	Cikli i Ulët Parashkollor	1,100	198,000
3	Kontabilitet-Financë	1,100	198,000
4	Administrim Publik	1,100	198,000
5	Turizëm	1,100	198,000
6	Histori-Gjeografi	1,100	198,000
7	Gjuhë -Letërsi	1,100	198,000
	Fakulteti i Shkencave të Natyrës		
8	Bio-Kimi	1,500	270,000
9	Matematikë-Fizikë	1,500	198,000
	Universiteti i Korçës Fakulteti i Ekonomisë		
1	Financë	1,100	198,000
2	Menaxhim	1,100	198,000
3	Marketing	1,100	198,000
4	Turizëm	1,100	198,000
5	Turizëm/Pogradec	1,100	198,000
	Fakulteti i Mësuesisë		
6	Cikli i Ulët	1,100	198,000
7	Cikli i Ulët Parashkollor	1,100	198,000
8	Gjuhë -Letërsi	1,100	198,000
9	Infermieri	1,500	270,000
	Fakulteti i Bujqësisë		
10	Agrobiznes	1,100	198,000
11	Hortikulturë	1,100	198,000
	Universiteti i Elbasanit		
1	Punonjës Social	1,100	198,000
2	Filozofi-Sociologji	1,100	198,000
3	Gjuhë-Letërsi	1,100	198,000
4	Histori-Gjeografi	1,100	198,000
5	Edukatë Qytetare	1,100	198,000

6	Financë-Kontabilitet	1,100	198,000
7	Administrim-Biznes	1,100	198,000
8	Cikli i Ulët	1,100	198,000
9	Cikli i Ulët Parashkollor	1,100	198,000
10	Matematikë-Fizikë	1,100	198,000
11	Biologji-Kimi	1,500	360,000
12	Edukim Fizik e Sporte	2,000	360,000
13	Infermieri	1,500	270,000
14	Ekonomia dhe e Drejta	1,100	198,000
15	Teknologji Informacioni	1,100	198,000
	Universiteti i Shkodrës Fakulteti i Ekonomisë		
1	Administrim-Biznesi	1,100	198,000
2	Financë-Kontabilitet	1,100	198,000
3	Turizëm	1,100	198,000
	Fakulteti i Drejtësisë		
4	Drejtësi	1,100	198,000
	Fakulteti i Shkencave të Edukimit		
5	Cikli i Ulët	1,100	198,000
6	Cikli i Ulët Parashkollor	1,100	198,000
7	Edukim Fizik e Sporte	2,000	360,000
	Fakulteti i Shkencave të Natyrës		
8	Matematikë	1,100	198,000
9	Fizikë	1,100	198,000
10	Infermieri	1,500	270,000
11	Biologji-Kimi	1,500	270,000
	Fakulteti i Shkencave Shoqërore		
12	Gjuhë-Letërsi	1,100	198,000
13	Histori	1,100	198,000
14	Gjeografi	1,100	198,000
	Universiteti i Durrësit		
	Fakulteti i Biznesit		
1	Administrim-Biznes	850	153,000
2	Financë-Kontabilitet	850	153,000
3	Financë-Kontabilitet (Fil. Peshk.)	850	153,000
	Fakulteti i Shkencave Politike- Juridike		
4	Drejtësi	1,100	198,000
5	Drejtësi (Fil. Peshk.)	1,100	198,000
	Fakulteti i Edukimit		
6	Cikli i Ulët	1,100	198,000
7	Cikli i Ulët (Fil. Peshk.)	1,100	198,000
8	Psikologji-Sociologji	1,100	198,000
	Fakulteti i Studimeve Profesionale		
9	Infermieri	1,500	270,000

10	Infermieri (Fil. Peshk.)	1,500	270,000
----	--------------------------	-------	---------